



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Mars 2021

Nr: 109

VENDIM

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE
INSTITUTI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE, PËR
SHTYRJEN E AFATIT PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR REFERENDUMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 33, 42, 47, 53, 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutimet e përfaqësuesve të komitetit të nismës ligjvënëse,

V Ë R E N

Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, me përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve z. Kristaq Kume, zj. Brisida Gjickondi dhe zj. Eneda Bozheku, kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 11, datë 30.06.2020 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi i sipërcituar ka përcaktuar afatin 3 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi për mbledhjen e nënshkrimeve. Afati përfundimtar për depozitimin e fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve për t’u depozituar në KQZ nga përfaqësia/ komiteti përfaqësues i nismës, është data 30.09.2020.



Data: 2 Mars 2021
Nr. 109

Për shqyrtimin e kërkesës së nismës ligjvënëse të zgjedhësve Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve për projektligjin “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”

Referuar pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, fletët e mbledhjes së nënshkrimeve depozitohen në KQZ, jo më vonë se pesë ditë pas përfundimit të procesit të mbledhjes së tyre, së bashku me dokumentacionin shoqëruar të kërkesave të zgjedhësve që nuk mund të nënshkruajnë në vendet publike, procesverbalet e grupeve mbështetëse të nismës për zgjedhësit që, për shkak të paaftësive fizike, nuk mund të nënshkruajnë vetë, si dhe mbledhjen e nënshkrimeve në mënyrë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet, si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënëse të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në datën 01.10.2020, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse. Kërkesa është dërguar me postë më datë 30.09.2020.

Referuar pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe duke marrë në konsideratë se kërkesa është dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përpara mbarimit të afatit 3 mujor si dhe argumentat e parashtruara nga ana e kërkuesit në seancë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi si të ligjshme kërkesën për zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për referendimet në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 18, datë 02.11.2020 vendosi zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për referendimet në Republikën e Shqipërisë” deri në datën 28 Shkurt 2021.

Në datën 05.02.2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa me nr. 962 prot., për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse për projektligjin “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 53 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit në rast se ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural.

Neni 182 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm i një akti administrativ shtyhet në rastet kur organi publik ka vendosur shtyrjen e tij për një afat të caktuar.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke marrë në konsideratë se kërkesa është dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përpara mbarimit të afatit të përcaktuar në vendimin nr. 18, datë 02.11.2020 si dhe argumentat e parashtruara nga ana e kërkuarit në seancë vlerëson se, kërkesa e depozituar nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve për të propozuar projektligjin “Për referendumet e Republikës së Shqipërisë”, është e ligjshme dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe nenit 53, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S :

- 1- Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projekt-ligjit “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 Maj 2021.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

